**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**"FIZIOTERAPI"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "REALD"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dhimitraq Stratobërdha
2. Dr. Enkeleda Sinaj

Janar/ 2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TË PROGRAMIT

Programi i studimit i ciklit të dytë "Master profesional" në "Fizioterapi" ne IAL Reald, është hapur me Urdhër Nr. 449, datë 25.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky program organizohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, dhe u ofron studentëve, që kanë diploma bachelor në fizioterapi të interesuar të thellojnë aftësitë e kompetencat e tyre profesionale, për tu diplomuar e integruar si profesionistë të kësaj fushe, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, ku nevojitet profesioni i tyre.

Vlerësimi i jashtëm i programit u krye në përputhje me aktet ligjore e nënligjore ne fuqi dhe udhëzimet dhe formati standard i ofruar nga ASCAL.

IAL Reald në këndvështrimin e misionit dhe qëllimit ka synuar nëpermjet këtij program ti shërbejë pjesës jugore të vendit, bazuar edhe në nje studim të tregut të punës. Për hartimin e programit është marrë eksperienca më e mirë e IAL, të vendit dhe me gjerë, me synimin e ruajtjes së interesave dhe vlerave kombëtare dhe për te kontribuar në zhvillimin e arsimin të lartë, në pjesën jugore te vendit.

Programi i studimit Master profesional në Fizioterapi është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Pasqyruar këto edhe në Statut dhe Rregulloret e Fakultetit dhe programit.

Edhe pse specifikisht ky program përgatit Fizioterapistë, ai synon të pajisë studentët me njohuritë dhe shprehite e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MP ne Fizioterapi përmbushin formalisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukturë, organizim, përbërje të stafit PAE, stafit ndihmës akademik dhe përmbajtjes së programit që ofrohet. Themi formalisht sepse ka mospërputhje me aktet ligjore në drejtim të përbërjes e kualifikimit të stafit, edhe pse Institucionin ka synuar dhe arritur në përgjithësi garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies edhe pse nuk ka udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit.

Hapësirat për realizimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme. Ato janë të pajisura me teknologji, mjete e orendi bashkëkohore, të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen, por individualisht në perputhje me prioritetet e tyre në fushën e kërkimit shkencor, për të fituar tituj e grada shkencore. Puna e organizuar nga Institucioni e me projekte të mbështetura financiarisht mungon. Puna shkencore vetë brenda Institucioni është e pamjaftueshme, megjithatë dëshirën për mbështetje të studenteve nga personeli akademik në këtë drejtim që u shpreh edhe gjatë vizitës në IAL Reald. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e mjeteve didaktike, sipas kërkesave të tyre. Biblioteka ishte e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore, por që së shumti i përkasin fushave dhe programeve te përafërta. Studentet, materialet specifike te programit i

merrnin nga personeli akademik. IAL Reald harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit pasqyruar dhe në Rregulloret përkatëse, e duke i bërë transparente e të aksesueshme për të interesuarit,.

IAL Reald përdor instrumente për sigurimin e cilësisë. Institucioni ka përcaktuar politikat e veta, strukturat dhe procedurat, që përputhen me ligjet e udhëzimet për këtë problem. Kryesisht veprohet në momentet e akreditimeve detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik, megjithate nuk ka të dokumentuara të dhëna nga procedurat periodike, me përjashtim të pyetsorit studentit dhe formularit vetvlersimit të personelit akademik, po ashtu raporte analitike mungojnë për vitin akademik 2018-2019.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL dhe programeve të studimit, 2017”, nisur nga aplikimi i Kolegjit Universitar "Reald" për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Fizioterapi", u ngrit nga ASCAL një grup per vlerësimin e e jashtëm të këtij programi (GVJ) dt.19.09.2019 i përbërë nga Prof. Dhimitraq Stratobërdha dhe Dr. Enkeleda Sinaj dhe mbështetur nga MSc Aviola Bardhi specialiste ASCAL. Pas shqyrtimit të dokumentacionit (edhe atij shtesë) dërguar nga IAL Reald, nga GVJ me 01.10.2019 u përgatit agjenda e vizitës në IAL Reald dt.14.10.2019 dhe u dakordsua me IAL që vizita të ishte datë 21-22.10.2019.

Sipas agjendes ditën e pare datë 21.10.2019 morëm takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjesin e Departamentit që mbulon programin. Më pas me antarët e GVB të IAL Reald, që u pasua nga takimi me stafin akademik të programit MP ne Fizioterapi. Pas dite patëm takim me studentët e MP Fizioterapi dhe vizitë më pas tek sekretaria mësimore.

Ditën e dytë datë 22.10.2019 morëm takim me GVB, me Zyrat e Burimeve Njerzore dhe Këshillimit Karrierës e Kërkimir Shkencor që u pasua nga një vizitë në auditorë, laboratorë bibliotekë dhe shërbimet për student. Takimi përmbyllës ishte me Përgjegjësin e Departamentit. Në të gjitha takimet u diskutua dhe evidentuan problemet, që kishte programi bazuar në Dokumentacionin e Institucionit, në atë cfarë ishte e dukshme dhe e matshme, opinionet dhe mendimet e drejtuesve, personelit akademik, atij mbështetës, dhe studentëve.

Kordinatore teknike e ASCAL është Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 08.01.2020 përmes sistemin AMS dhe me shkresë Nr. 8 Prot, datë 08.01.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft- Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, KU “Reald” është njohur me Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 13.01.2020, KU “Reald” përcjell në sistemin AMS përgjigjen për Draftin, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Fizioterapi"

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1**Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit ofrohet në mbështetje të interest kombëtar. Institucioni ofron programe të licensuar nga ministria për arsimin e lartë, të cilat synojnë aftësimin e studentëve dhe rritjen e mundësisë së punësimit të tyre në fushën e mjekësisë, në përputhje me interesat kombëtare ne jugun e vendit, ku dhe operon më së shumti. |
| **Kriteri 2**Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Nëpërmjet programit të studimit që ofrohet synohet të ruhen vlerat kulturore kombëtare siç janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatiten profesionistë të ardhshëm që do të mbartin këto vlera, si dhe për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë. |
| **Kriteri 3** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Duke analizuar misionin dhe qëllimin e institucionit, shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që Programi Master Profesional në "Fizioterapi" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky IAL, për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë, edukimin e vlerave më të mira morale, zhvillimin e kërkimit shkencor, formimin cilësor profesional të specialistëve të lartë, pasqyrë e të cilave do të jenë të diplomuarit në fushën e fizioterapisë. |
| **Kriteri 4** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programi Profesional në "Fizioterapi" hapet dhe është hartuar për t'iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit e në vecanti pjesës jugore. Sipas dokumentacionit të Institucionit, hartimi i tij u nxit nga një nevojë tashmë e shoqërisë në kushtet e reja kur krahas sektorit publik shëndetësor kemi edhe atë privat qoftë ky spitalor apo ambulator, e deri tek qendrat estetike, ku kërkohen metoda e mjete bashkëkohore menaxhuese, reabilituese e rekuperuese nga individë e grupe të caktuara në nevojë për fiziomasokinesiterapi e reabilitim. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **x** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Duke iu referuar Strategjisë së Zhvillimit 2016-2021 miratuar nga Bordi Drejtues ne Janar 2016 (pikat C dhe D te kësaj Strategjie). dhe misionit te Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore, (shprehur edhe në rregulloren e programit të studimit "Master profesional" në "Fiziotarapi" Kreu II nenet 5,6,7,8), hartimi dhe organizimi i programit të studimit MP ne Fizioterapi është në përshtatje me objektivat dhe strategjinë afatmesme të IAL, me misionin, strategjinë e statutin e IAL, duke synuar standardet për nje IAL cilesor.. Programi i studimeve MP në Fizioterapi ofrohet si rrjedhoje e kesaj strategjie zhvillimi institucional.( Evidenca 3, 7 ) |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Rregullorja e programit të studimit "Master profesional" në "Fiziotarapi" është hartuar në përputhje me aktet kryesore të IAL. Statutin i Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Rregullore e IAL Miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik dhe Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore, Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik). Rregullorja e programit përcakton misionin, strukturën e brëndshme dhe mënyrën e funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve të IAL, etj |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit ka të përcaktuar emërtimin "Fiziotarapi", organizimin e tij me kohë të plotë, sipas kritereve ligjore të parashikuar në LAL. Përmbajtja e programit të studimit është hartuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të IAL. Në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh që emërtimi i programit të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korrniza Shqiptare e Kualifikimit. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. | Programi Profesional në "Fizioterapi" hapet dhe është hartuar për t'iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit e interesave të vendit e në vecanti pjesës jugore. Sipas dokumentacionit të Institucionit, hartimi i tij u nxit nga një nevojë tashmë e shoqërisë në kushtet e reja kur krahas sektorit publik shëndetësor kemi edhe atë privat qoftë ky spitalor apo ambulator, e deri tek qendrat estetike, ku kërkohen metoda e mjete bashkëkohore menaxhuese, reabilituese e rekuperuese nga individë e grupe të caktuara në nevojë për fiziomasokinesiterapi e reabilitim. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.3<br>Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi synon formimin e studenteve nepermjet dhënies se njohurive për formimin teorik dhe praktik në fushën e mjekesise me objektiv kryesor formimin e specialisteve në keto fusha, të aftë për të punuar si fizioterapeut, menaxhierë dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive duke filluar me ato teorike, të fushës dhe ndihmëse duke vijuar me thellime në aspektin praktik. Kjo e shprehur edhe në syllabus-et për cdo lëndë ku pasqyroheshin objektivat mbi dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale qe synoheshin, dhe që kërkon tregu i punes. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Ky program eshte hapur pas një studimi jo të mirëfilltë nga ekspertë të fushës, të tregut të punës, në veçanti në Rajonin e Jugut, megjithatë bazuar ne strategjinë e zhvillimit të institucionit, duke vlerësuar dhe marrë në konsideratë edhe interesin kombëtar, ai është hartuar si programi i studimit të ciklit të dytë në Fizioterapi duke diplomuar këtë vit për herë të parë.<br>Nga takimet me drejtues të Universitetit, stafin pranë universitetit, dhe një student që tashmë kishte mbaruar programin Bachelor në Fizioterapi dhe vazhdonte Master në Fizioterapi, pyetur mbi kërkesat dhe punësimin e kolegëve të tyre, u informuam që njohuritë dhe aftësitë e tyre, fituar nga programet e studimit ishin në përputhje me ato çka kërkoheshin në vendet e punës, ku ata punonin, madje jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e tjera të Europës.<br>Ne takimin planifikuar me studentë që ndiqnin programin e Masterit takuam vetëm një student i cili ishte vetpunësuar, ku dhe ofronte shërbim të fizioterapisë dhe rehabilitimit. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive duke filluar me ato teorike, të fushës dhe ndihmëse duke vijuar me thellime në aspektin praktik. Kjo e shprehur edhe në syllabus-et per cdo lëndë ku pasqyroheshin objektivat mbi dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që synoheshin, dhe që kërkon tregu i punës. Megjithatë Syllabet nuk ishin plotësisht në përputhje me |

| | |
|---|---|
| | VKM 41 në element. që do ti relatojmë më poshtë. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | IAL Reald pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, publike ose private, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e programit. Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe të projekteve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë institucioni. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë shtetit ose kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje nuk merret si ndërprerje e studimeve dhe rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit. |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | IAL REALD, kryesisht në shkencat mjekësore aplikon praktikat më të mira të institucioneve kombëtare dhe atyre të vendeve të BE. Janë vlerësuar dhe adoptuar praktikat e universiteteve italiane në fushën e mjekësisë, Universiteti i Fogias, me të cilin ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim përvoje, stafi akademik, etj Megjithate nuk na u paraqit një material i tillë i shkruar dypalësh nga dy Institucionet. |
| **Kriteri 6.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh që emërtimi i programit të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Kornniza Shqiptare e Kualifikimit. Aty përfshihen aftësimi profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në kërkesat (tashmë të njohura nga institucioni) ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. |
| **Kriteri 7.** Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin. | Programi është i hartuar në gjuhën shqipe. Nuk ka ndonjë modul në gjuhë te huaj. Pra kanë mundësi për të ndjekur programin e studimit "Master profesional" në "Fiziotarapi" nga vende të tjera vetëm studentët nga Kosova, nga Maqedonia e Veriut, nga Serbia e Mali i Zi. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën shqipe. Në program akoma nuk kishte të tillë. (Evidenca 7 neni 37.13) |
| **Kriteri 8.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. | Ky program studimi ofrohet në përgjigje të kërkesës së studentëve te diplomuar në bachelor për të vazhduar studimet e ciklit të dytë në këtë drejtim dhe vlerësimit të stafit drejtues për nevojën e plotësimit të institucionit me programe në këtë fushë studimi. Programi i studimit "Master profesional" në "Fiziotarapi" synon të plotësoje nevojat e Jugut të Vendit për |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | fizioterapeut profesioniste. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| **Standardi I.4<br>Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Drejtuesit e këtij Institucioni (Fakulteti i Shkencave Mjekësore nje përvoje 10 vjecare) dhe stafi i programit Fizioterapi janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre për realizimin sa më cilësor të programit të studimit edhe pse ky staf ka disa mangësi në tituj e grada shkencore apo në specialitetet që ata kanë. Ka përgjegjësi në hartimin e programit të studimit në përgjithesi konform akteve ligjore dhe nënligjore, por edhe krijimi i mjedisit të duhur mbështetës për programin me kabinete e teknologji të kohës. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit e shprehur edhe në emërtimin e programit të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korrniza Shqiptare e Kualifikimit. Aty përfshihen aftësimi profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në kërkesat (tashme te njohura nga institucioni) ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Të gjitha modulet janë të kodifikuara dhe të vleresuara në kredite (ECTS). Viti akademik i planit të studimit përmban 60 ECTS. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, që është Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane shprehur këto edhe ne Diplomë dhe Suplementin e diplomës. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" | Institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik Fizioterapi, brenda |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucioni. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **x** | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Njësitë dhe personeli i angazhuar në mbarëvajtjen e programit MP në Fizioterapi kanë të përcaktuara detyrat dhe rolet në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. Si personeli akademik ashtu edhe personeli ndihmës mësimor shkencor dhe personat përgjegjës të laboratoreve, pjese e strukturës së IAL mbikqyrin bashkpunojnë dhe mbështesin sipas detyrave që kanë gjatë proçesit të realizimit të programit gjate vitit akademik. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | IAL për programin Master në Fizioterapi, për të qenë koherent dhe për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Vlorë, klinikën Fizio Life dhe Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për hartimin e programit dhe realizimin e praktikave si element i rendësishëm për formimin e studentëve. Por nuk na u paraqiten marrveshjet si dokument. Nga institucioni është paraqitur vetem një listë emrash institucionesh. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | IAL për realizimin e programit të studimit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal të Vlorës, si dhe me Drejtorinë e Shëndetit Publik, apo Klinika Fizio Life për realizimin e praktikave mësimore të studentëve, por nga sa u pa gjatë vizitës kjo kishte të bënte me praktikat e Programit Menaxhim Infermieror dhe vetëm Klinika Fizio Life kishte mbështetur praktikat profesionale te studentve (5 studentë) të Programit MP ne Fizioterapi gjatë vitit akademik 2018-2019. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të | Praktika mësimore, përvec se kryhet në kabinetin e |

| | |
|---|---|
| lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron. | Fizioterapisë brenda institucionit, bashkëpunon me Klinikën Fizio Life dhe mbikqyret nga një pedagog (mjafton duke patur parasysh numrin e studenteve) që vlerson përvetësimin e njohurive praktike të studentit praktikantë. |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | IAL nuk ka patur te tilla aktivitete për MP Fizioterapi, por per fusha të tjera fton studente kur në bashkëpunim me institucione të tjera ka zhvilluar konferenca apo trajnime profesionale, në ambientet e IAL dhe i pasqyron këto në planet e sektorit kerkimor shkencor dhe Buletinin e IAL. |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Departamenti raporton lidhur me efikasitetin e perfitimeve që rrjedhin nga bashkëpunimi me institucione të tjera këto më së shumti i përkasin programit Menaxhim Infermieror dhe kryesisht lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve në këto institucione. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1** **Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1**Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master profesional ne Fizioterpi eshtë organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Pasqyruar keto edhe ne Statut dhe Rregulloret e Fakultetit dhe programit. Por vihet re se nuk përputhet nominimi I lëndëve si veprimtari nga A në E. sipas VKM 41. Në programin e MP Fizioterapi Reald akoma si më parë veprimtaritë janë ndarë nga A në F. |
| **Kriteri 2.**Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Edhe pse specifikisht ky program përgatit Fizioterapistë ai synon të pajisë studentët me njohuritë dhe shprehite komplementare që do tu sherbejnë atyre në punë. Në program janë parashikuar lëndë e module të etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor njohuri komunikimi, psikologji dhe didaktikë nga 2 kredite për cdo modul. |
| **Kriteri 3.**Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Të diplomuarit nga ky program përftojnë njohuritë dhe kompetecën e duhur profesionale që duhet në tregun e punës si brënda ashtu dhe jashtë vendit, dhe krijojnë mundësi thellimi në specialitet, apo studime më të thelluara. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi MP Fizioterapi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për zgjidhjen e problemeve fizioterapeutike. Nëpërmjet lëndëve teorike dhe praktikës synohet qe të aftësohet studenti të punojë dhe zgjidhë i pavarur këto probleme. ( Evidenca 13) |
| **Kriteri 5.**Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet | Struktura e programit përmban ne përputhje me aktet ligjore (VKM Nr. 41) 1. kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të |

| | |
|---|---|
| që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Krediteve (ECTS);<br>2. kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;<br>3. objektivat formues;<br>4. veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;<br>5. kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;<br>6. planin mësimor;<br>7. kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;<br>8. programin lëndor (*Syllabus*-et);<br>9. profilin e programit;<br>**10.** diplomën dhe suplementin<br>Por praktika profesionale është llogaritur si veprimtari E, ndërkohe që sipas VKM duhet të jetë D. Ndërsa provimi përfundimtar është llogaritur F ndërkohë që duhet të jetë E. |
| **Kriteri 6** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Bazuar ne VKM nr. 41 disiplinat jane grupuar A,B,C,D,E, por provimi perfundimtar eshte lene akoma me kategorine F qe tashme eshte hequr.<br>Duke iu referuar akteve ligjore e udhëzimeve nga vlersimi ynë rezulton që në këtë standard vendi që zenë disiplinat të grupuara janë:<br>**A-** 13.3%, **B-** 50%, **C-** 6.6 %, **D-** 16.6, **E-** 13.3%<br>Ky raport lidhet me peshën e dhënë në program të lëndëve karakterizuese (B), që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik dhe praktikës profesionale (D) |
| **Kriteri 7**Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. | Duke iu referuar pasqyrës së programit, gjatë vitit janë parashikuar 60 kredite. Ngarkesa vjetore në orë është 722.5 në auditor dhe 777,5 ore jashtë auditorit.<br>Praktika profesionale përkonte me 33.2% të orëve, leksionet 18.9% dhe pjesa tjetër laboratore e mësim klinik, cka shpreh edhe karakterin profesional të këtij programi dhe orientuar drejt nga direktivat e aktet ligjore kombëtare e evropiane. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **x** | | |

**Standardi II.2**
**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe**

| standardet e cilësisë për këto njësi. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Si njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit MP ne Fizioterapi përmbushin formalisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukture, organizim, përberje të stafit PAE, stafit ndihmës akademik dhe përmbajtjes së programit që ofrohet. Por drejtuesi i njësise kryesore dhe bazë janë mbi limitin e moshës së lejuar për punesimin me afat të pacaktuar. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Programi i studimit plotëson kriteret e nevojshme formale për sa i përket numrit te stafit, titujve akademike apo shkencore të drejtuesve dhe stafit përkatës. Përgjegjësit e programit të studimit kanë tituj akademike profesor apo profesor të asociuar dhe grade shkencore. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. | Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MP ne Fizioterapi përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik. Raportet midis personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme ne shifra absolute është 10 / 7 pra 58.8% PAE me 41.2% PAK. por edhe ceshtja e moshës e personelit me kohë të plotë, që nuk ishte në përputhje me ligjin edhe pse mund të realizonte mbi 70 % te ngarkesës vjetore. |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Programi i studimit plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket numrit te stafit, titujve akademike apo shkencore të drejtuesve dhe stafit përkatës, por vihet re se mosha e personelit me kohë të plotë, nuk ishte në përputhje me ligjin. Si njësia kryesore edhe ajo bazë i pergjigjen strukturës dhe përberjes nga pikpamja formale. |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. | Personeli mësimor që udhëheq praktikat profesionale është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve që udhëheq. Personeli ndihmes eshte funksional dhe në shërbim të laboratorëve e praktikave. |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin MP ne Fizioterapi kishte caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit (Vendimi Nr.2 I Rektoratit dt.13.11.2018) me të cilin u takuam dhe na u pergjigj vazhdimisht në kohën e vizites në institucion. Koordinatori ishte përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i | Koordinatori i programit ishte i azhurnuar mirë mbi mbarvajtjen |

| | |
|---|---|
| programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. | e programit dhe raportonte e bashkëpunonte në mënyrë të vazhduar me drejtuesin e njësisë përgjegjëse dhe dokumentonte çdo informacion lidhur me programin e studimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | x | | |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti ka informacionet dhe dokumentat e nevojshme për të gjithë elementet e programit të studimit: Rregullore - planet mësimore, numrin dhe ngarkesën mesimore të çdo pedagogu, organizimin e praktikave profesionale, orarin mësimor, strukturen e vitit akademik, kalendarin e provimeve, etj. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module, në të cilën përfshihet edhe praktika profesionale cka përkon me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programi studimit përmban elementët e mëposhtëm me kriteret përkatëse për secilin element ne zbatim te VKM 41/2018, pika 2.<br>a) Vit/Semestra-1 **vit/2 semestra**<br>b) Kredite në vit – **60 ECTS**<br>c) Numri i Lëndëve/moduleve, Eshte ndarë në 7 lëndë (duke përfshirë këtu edhe Praktikën profesionale) dhe përfundohet me një provim përfundimtar/mbrojtje mikroteze. Lëndët përmbajnë module të përshtatshme per formim profesional te fizioterapeutit dhe janë konceptuar për të patur raportin e duhur të teorisë me praktikat<br>d) Numri total i provimeve - **jo më shumë se 7 provime**<br>e) Ngarkesa totale në auditor/vit: **722.5 orë mësimore**<br>f) Format e mësimdhënies; **parashikohen disa forma** |

| | |
|---|---|
| | **mësimdhënie; ato jane të ndara qartë në planin mësimor për çdo lëndë/modul apo aktivitet tjetër formues.**<br>g) Kreditet korresponduese për çdo lëndë/modul jane percaktuar drejte..<br>Por programi nuk ishte në përputhje me VKM Nr. 41 kur lëndet sipas disiplinave vendoseshin nga A ne F, në një kohë që gërma F është hequr dhe provimi perfundimtar është D. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Programi i studimit MP ne Fizioterapi përmban planin mësimor, ku mund te gjendet informacion për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit që Ishin **722.5 / 777.5,** frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vleresimit te dijeve, cka përshkruhej në Syllabus dhe në rregulloren e programit.( Evidenca 13.2, dhe 17.2) |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Rregullorja e programit të studimit "Master profesional" në "Fiziotarapi" është hartuar në përputhje me aktet kryesore të IAL<br>Statutin i Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Rregullore e IAL Miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik dhe Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore, Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik).<br>I gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është pasqyruar në këtë Rregullore. ( Evidencat 2, 6, 7 ) Por në rregulloren e programit, neni 20, afati i studimit është 1 vit e 6 muaj. |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Përmbajtja e syllabus-eve e lëndëve /moduleve ka elementët e përcaktuar nga VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2 por nuk permbajne elementet si: titullari, ngarkesa, tipologjia. Lëndët /modulet mbulohen të gjitha me pedagogun përkatës. Metodat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të studentit janë të përshtatshme për çdo lëndë dhe në raporte të duhura sipas lëndës. Literatura e pasqyruar në syllabuse është profesionale e vendit dhe e huaj dhe e mundshme për tu disponuar nga studenti. Programet vetë, si në strukture dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe tu japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit. Pjesa e parë e syllabus-eve përmban vetem objektivat, në një kohë qe duhet të ketë elementet përmbledhje, rezultatet e te nxenit dhe |

| | |
|---|---|
| | koncepte themelore. Nga ana tjetër Syllabet nuk përmbajn emrin e titullarit apo pedagogut që ka përgatitur syllabin. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Institucioni synon të mundësojë përmirësimin e programeve të studimeve nëpërmjet personelit akademik në perputhje me aktualitetet shkencore si dhe të modifikojë kur e sheh të arsyeshme metodologjinë e mësimdhënies për të përmirësuar nivelin e përfitimit nga studentët.<br>Per përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies ky institucion konsideron në fillimin e çdo viti akademik mundësinë për modifikimin e metodologjisë duke marrë parasysh edhe sugjerimet e vetë studentëve të mbledhura në proçesin e vlerësimit të kurseve nga vetë studentët në fundin e vitit akademik paraardhës. (Evidenca 31) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | x | | |

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Janë të ndara qartësisht ngarkesa mësimore dhe raportet e formave të mësimdhënies (Leksione 137.5 ore, Seminare 315 orë, Praktika profesionale 240 orë). Pra pjesa teorike, leksionet zenë 19% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale 81% të orëve). Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij Program Studimi. Orët e praktikës profesionale 240 orë/vit zenë 33.2% të orëve në auditor. |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. | Emërtimi MP Fizioterapi e vendos programin, në ato që pregatisin specialistë të profesioneve te rregulluara me ligj përmbajtja e veprimtarive jep njohuri të mira profesionale, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive. |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit | Mënyra e ndërtimit dhe organizimit të programit MP ne Fizioterapi ne IAL Reald e jep mundësinë e arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve te pritshme të të nxënit që synon ky institucion. Semestri i pare me modulet legjislacion, metodologji didaktike e formuese, shkencat e rehabilitimit interdisiplinar dhe teknikat e integruara te rehabilitimit pregatit studenin për tu futur ne semestrin e dytë në specifikat |

| | |
|---|---|
| profesional. | perofesionale që i duhen një fizioterapeuti për arritjen e objektivave formuese të programit. ( Evidenca 13.2 ) |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Janë të ndara qartësisht ngarkesa mësimore dhe raportet e formave të mësimdhënies (Leksione 137.5 ore, Seminare 315 orë, Praktika profesionale 240 orë).Pra pjesa teorike, leksionet zenë 19% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale 81% të orëve). Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij Program Studimi. Orët e praktikës profesionale 240 orë/vit zenë 33.2% të orëve në auditor.<br><br>Programi i Studimit si nga forma edhe përmbajtja është i përafruar në masën e nevojshme me programe te njejtë, qoftë të IAL në vendin tonë qoftë edhe me programet ndërkombëtare. |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Si edhe me siper kemi keto raporte te formave të mësimdhënies (Leksione 137.5 ore, Seminare 315 orë, Praktika profesionale 240 orë). Pra pjesa teorike, leksionet zenë 19% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale 81% të orëve). Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij program studimi. Orët e praktikës profesionale 240 orë/vit zenë 33.2% të orëve në auditor. Ne kete kendveshtrim mundësohet arritja e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Literatura e pasqyruar në syllabuse është profesionale e mundshme për tu disponuar nga student, por e pakët dhe e pa përditsuar me ato te 5 viteve të fundit. Programet vetë, si në strukture dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe tu japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit. Synohet sipas informacionit që na u dha gjatë vizitës, që këtë vit ato të përditsohen mbi bazën e përvojës fituar gjatë vitit të parë, që është ofruar ky program MP në Fizioterapi. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë. | Programi i Studimit MP në Fizioterapi në IAL Reald si nga forma edhe përmbajtja është i përafruar në masën e nevojshme me programe të njejtë, qoftë të IAL në vendin tonë qoftë edhe me programet ndërkombëtare me se shumti pervoja italiane dhe garanton përfitimin e dijeve,aftësive dhe kompetencave të duhura në profesionistë të kesaj fushe dhe në nivelin e kërkuar për programe të ciklit të dytë master. |
| **Kriteri 8.** Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Programet vetë, si në strukturë dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe tu japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit. |
| **Kriteri 9.** Përmbajtja e | Përmbajtja e programeve të studimit mundëson punësimin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës dhe vetë fakti që disa nga studentët ishin punësuar është tregues i kësaj arritje. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Personeli akademik, si PAE edhe PAK realizon ngarkesën mësimore në përputhje me planin e studimit sipas oreve e krediteve për secilin lëndë/ modul. Ata kanë tituj akademike Profesor apo Profesor të asociuar apo grade shkencore Dr. si per PAE dhe PAK. Personeli mësimor që udhëheq praktikat profesionalizuese është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve. Ky lloj aktiviteti parashikon angazhimin e njëkohshëm të tutorit me jo më shumë se 3 studentë njëkohësisht. Personeli akademik efektiv përbën 58.8% të stafit akademik të programit. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Personeli PAE dhe PAK është i angazhuar në mbarëvajtjen e proçesit didaktik. Njohin detyrat dhe përgjegjesitë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie kanë formalisht si grup nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, por jo sipas fushave ku ato janë ekspertë dhe specialist. Këto jane pasqyruar edhe në Rregulloren e Kolegjit Universitar "REALD" Neni 32, Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik. |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën | Për sa i përket stafit që mbulon programin MP në Fizioterapi dhe titujve akademike apo gradave shkencore të tyre, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie kanë mangësi të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, sipas fushave ku ato janë ekspertë dhe specialist. Punësimi i stafit akademik nuk ka arritur ti përmbushë kriteret e ligjit si përsa i përket kritereve administrative ashtu edhe ato të titujve e gradave shkencore apo specialitetit të lëndëve që mbulojnë. (Dokumenti |

| | |
|---|---|
| e moduleve të tij. | nr 3 ne dokumentat e kerkuara gjate vizites.) |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Vetë numri i vogël i studentëve në programin MP në Fizioterapi i mundëson një tutorim efikas dhe mbikqyrje të vazhdueshme të mbarvajtjes se studentëve në gjithë hapat për realizimin e programit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Personeli ndihmës është funksional dhe në shërbim të laboratoreve e praktikave. Të gjitha laboratorët e IAL janë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve për realizimin e procesit mësimor. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **x** | | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Programi i studimit është hartuar në përshtatje të kërkesave të tregut të punës, edhe pse nuk ka një studim të mirfilltë. Gjate punes, për hartimin e programit është kontaktuar e diskutuar me partnerë brenda dhe jashtë vendit, për të thithur e pasqyruar në program mendimet dhe sugjerimet e ndryshme, kjo sipas drejtuesve. Por duke iu referuar. (Aneksi/shtojce 18) ka si te dokumentuar vetem nje liste me institucionet e bashkepunimit, por nuk jane marreveshjet dhe nuk flitet per hartimin e ketij programi studimi. |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në | Një pjesë e studentëve, që kanë mbaruar ciklin e parë të |

| | |
|---|---|
| kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | studimeve bachelor ne Fizioterapi, aktualisht janë të punësuar në institucione shëndetësore publike dhe private. Gjithashtu, programi është bazuar edhe në nevojën e tyre për vijimësinë e studimeve në ciklin e dytë, por dhe të sugjerimeve, që ata kanë paraqitur gjatë konsultimeve të bëra me ta nga grupi i punës së IAL Reald. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. | Ka komunikim me studentët e diplomuar. Ata konsiderohen si një burim i nevojshëm për të mare sugjerime në funksion të rishikimit të programit dhe rritjes së cilësisë së zhvillimit të procesit teoriko-praktik. |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. | Vetë programi aktual është i ri dhe qysh në fillim është hapur duke synuar tu pergjigjej kërkesave dhe nevojave specifike lokale dhe zhvillimi. IAL bashkëpunon edhe me IAL publike, kryesisht të huaj, në funksion të riorganizimit të programeve dhe hartimit të programeve të përbashkëta. Në vazhdën e experiences me ciklin e parë të programit Bachelor në "Fizioterapi" (riorganizuar në bashkpunim me Universitetin e Fogias në Itali) po punohet të realizohet edhe per MP Fizioterapi. (Aneksi /shtojce 18) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | x | | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Udhëzues të vecantë nuk ka, edhe pse IAL duke iu referuar rregulloreve te Fakultetit apo Departamentit e parashikon këtë në një fare mënyre. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | U konstatua se IAL për plotësimin e këtij kriteri ka ngritur NJSBC e cila sipas rregullores së miratuar merret me monitorimin e procesit mesimor, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Synohet në përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe nga strukturat përkatese është përfshirë mundësia e trajtimit të ankimimeve, si e drejte e studentëve dhe në shërbim të përmirësimit të punës për realizimin e programit. (Aneks/shtojce 23) |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | IAL Reald ashtu si për programet e tjera edhe për Programin e MP ne Fizioterapi nëpërmjet NSBC publikon në web-in e IAL raportin e rezultateve të vlerësimit. Por per këtë vit akademik 2018-2019 nuk ka një të tillë |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pjesë e këtij procesi është edhe Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.( Aneks/shtojce 24 ) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në këtë program MP në Fizioterapi sipas Rregullores sw Fakulteti Kreu III Elementet e Studimeve Neni 17, janë përfshirë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si vijon:<br>Elementët kryesorë të punës mësimore janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikat profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomës.<br>Sipas Rregullores cdo departament mund të përcaktojë edhe elementë të tjerë të punës mësimore, veçanërisht në fushën e kontrollit të dijeve.<br>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë sipas elementëve të mësipërm të studimit për çdo disiplinë, përcaktohet nga personeli akademik përgjegjës për të, në bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Personeli akademik është koshient për përgjegjësitë që ka dhe angazhohet për të ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit MP ne Fizioterapi në përgjithësi dhe specifikisht per module te vecanta gjithashtu është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij (Aneksi/shtojce 24 ) |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni AL Reald mundëson nëpërmjet auditoreve dhe laboratoreve, pajisur me mjedise e teknologji bashkëkohore, përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme për Programin MP ne Fizioterapi në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e tregut të punës. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e | Personeli akademik me përgjegjesi është i angazhuar në mësimdhënie në programin MP ne Fizioterapi është I ri në këndveshtrimin e eksperiences lidhur me shpjegimin e |

| | |
|---|---|
| njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | njohurive dhe koncepteve, dhe profilin e fushës që mbulon, por synon tu përmbahet tematikave të duhura për studentin. (Aneksi shtojce 24 ndihmon vleresimin e performances tyre dhe është nxitës për ata në këtë drejtim. |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Institucioni duke u bazuar ne eksperiencen e fituar gjate programit bachelor në fizioterapi ka një vleresim për përmirësimin e formave e metodave te mësimdhënies dhe ka përfshirë edhe studentët në këtë proces për një përmirësim të programit MP në Fizioterapi. Aneksi shtojce 23 |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Personeli akademik është fleksibel e përdor metoda interaktive dhe diskutimi gjatë mësimdhënies.<br>Aneksi shtojce 24 |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Format dhe metodat e mësimdhënies synojne te inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, dhe mbështetjen nga mësimdhënësi e ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **x** | |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Hapësirat për realizimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme. Ato janë të pajisura me teknologji, mjete e orendi bashkëkohore, të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Të tilla janë sallat dhe auditoret e leksioneve, seminareve me kubaturë, vende dhe pajisje të nivelit bashkëkohor. Vlen të përmendim Kabineti i Fizioterapisë ka 6 shtretër në sip. 78m2, kabineti informatikës 20 vende 65m2, biblioteka 20 vende në 100m2, etj. |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit | Nga vizita në institucion rezultoi se ambientet e vëna në dispozicion për procesin mësimor janë të bollshme, funksionale dhe të pajisura me mjete e teknologjinë e nevojshme për realizimin me cilësi si të procesit mësimor dhe |

| | |
|---|---|
| mësimor dhe praktikave. | praktikave. |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | IAL është kujdesur që të pajisë e instalojë në salla, auditore e mjedise të tjera teknologjinë e nevojshme informatike dhe personeli akademik e studentët shfrytëzojnë këtë infrastrukturë informatike (IT) të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Procesi mësimor i informatikës zhvillohet në sallën e IT. |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Studentet sigurojnë nga stafi akademik literature bazë dhe orientohen mbi atë ndihmëse, si fizike dhe elektronike, cka garanton marrjen e njohurive të përgjithshme e specifike parashikuar në program. (Aneksi/shtojce 28) |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Studentet dhe stafi akademik kanë akses të plotë të shfrytëzojnë bibliotekën, e cila është në dispozicion të tyre në çdo orë të ditës. Mjedisi i bibliotekës është komod i aksesueshem lehtë.<br>Materialet janë te pakta specifikisht për Fizioterapi. Kryesisht ato i përkasin fushave të përaferta. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Kryesisht operohet me leksionet e përgatitura nga pedagogët dhe material fizike në bibliotekë. Nuk aksesohet nga personeli akademik dhe studentët libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Infrastruktura laboratorike e nevojshme, (si në IAL edhe në institucionet bashkpunuese, Spitali Vlorë dhe Klinika Fizio Life) për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Ka një operim për komunikim elektronik por jo i organizuar në rang institucioni dhe në shërbim të përdorimit të materialeve të botuara te lidhura me fizioterapinë.<br>Aneksi /shtojce 29 |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë | Personeli akademik dhe studentët, kanë hapsirat e tyre ne sistemin informatik të IAL dhe e shfrytëzojnë këtë sistem |

| | |
|---|---|
| sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | komunikimi të brendshëm. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Personeli akademik e konsideron pjesë të rëndësishme të formimit të profesionistëve të rinj punën përgatitore për diplomim dhe orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Institucioni AL Reald ka organizuar strukturat/ njësitë në nivel institucional të tilla si NJSBC, zyra e karrieres, koordinator i përgjithshëm i programeve, koordinatorët e programeve duke synuar që nëpërmjet tyre të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë, me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Njësia kryesore Fakulteti dhe ajo bazë Departamenti janë përgjegjëse (dhe këtë e pasqyrojnë në rregulloret e tyre) për sigurimin e cilësisë se mësimdhënies dhe ndërgjegjsimin e personeli akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit. |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | IAL është i predispozuar, nëpërmjet strukturave dhe njësive përgjegjëse të mbështesi eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies nepermjet propozimeve mbi bazën e nevojave që kanë, në Organet Drejtuese te Institucionit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme, por individualisht për të fituar titujt e gradat shkencore, në përputhje me prioritetet e tyre në fushën e kërkimit shkencor, por kjo gjë ndihmon edhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe nga ana tjeter publikohen në buletinin periodik të IAL Reald. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Kryesisht personeli akademik angazhohet individualisht në trajnime e kualifikime shkencor gjë që ndihmon edhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Nuk ka dokumentim te trajnimit të vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik bazuar edhe ne Rregulloren e IAL Reald Kreu IV neni 32 janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Bazuar në Rregulloren e IAL Kreu 4 neni 32 pika 1-14 dhe neni 33 p si personeli akademik dhe personeli ndihmës-akademik kryesisht analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. |
| **Kriteri 8.** Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | IAL Reald ka bashkëpunim me kërkues shkencorë me tituj, grada dhe me eksperiencë, disa prej tyre i angazhon edhe si PAK në shërbim të cilsisë, për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. (Evidenca 26 ) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **x** | |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kanë rregulloret e tyre të funksionimit dhe të programit (ajo e MP Fizioterapi është hartuar në përputhje me aktet kryesore të IAL.<br>Statutin i Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Rregullore e IAL Miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik dhe |

| | |
|---|---|
| | Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore, Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik).<br>Janë të përcaktuara qartë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Këto rregullore janë publike dhe gjenden edhe online në faqen elektronike të IAL-së. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar edhe në Rregulloren e IAL Reald Kreu IV neni 32, Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik pika 1, personeli akademik në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve realizohet sic është parashikuar në rregullore e syllable por ka rëndësi edhe komunikimi i drejtëpërdrejtë gjate procesit mësimor që është efikas për shkak edhe të numrit të vogël të studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit. Procedura është pasqyruar ne Rregulloren e programit Cikli i Dytë i Studimeve "Master profesional" në "Fizioterapi" (Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik) Neni 29, Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Ato te detajuara paraqiten ne Syllabus-e:<br>**Vlerësimi i vazhduar 30%** (Frekuentimi 5% aktivizimi 5%, Detyra e kursit 5% Provim i ndërmjetëm 15 %)<br>**Provimi përfundimtar 70 %.** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme | Nuk realizohet një sistem elektronik testimi për të eliminuar abuzime e rritur transparencën. |

| | |
|---|---|
| abuzimi dhe rrisin transparencën. | |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në Rregulloren e Fakultetit te Shkencave Mjeksore Kreu V neni 24 testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë. Titullari i lëndës është anëtar i komisionit të provimeve dhe asistenti i tij ose në mungesë të asistentit caktohet një anëtar tjetër me vendim shkrim nga Përgjegjësi i Departamentit.( Evidenca 6 ) |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Në IAL Reald janë krijuar mekanizmat që gjatë procesit të vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, kjo të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni ka siguruar infrastrukturën e posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.( Evidenca 5, 6, 7 ) |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Nuk ka një praktike të tillë që të përshkruhet në dokumentacion apo nga vizita në Institucion, pavarsisht se pedagogët e kishin të lehtë komunikimin me studentët për arsye të numrit të pakët të tyre në programin MP në Fizioterapi. |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik gjate testimit të njohurive, dijeve me shkrim, siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. Ka Rregullore për zhvillimin e testimeve e provimeve (Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik) ku përshkruhen me detaje të gjithë hapat e procesit dhe përgjegjësitë përkatëse. (Evidenca 5, 6, 7) |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Në Kreun e VII neni 59 të Rregullores IAL përcaktohen modalitetet e vlerësimeve. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe | Në Kreun e VII neni 59 të Rregullores IAL përcaktohen modalitetet e vleresimeve studentët i kanë të garantuara nga Institucioni të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe |

| | |
|---|---|
| procedurat e vlerësimit. | procedurat e vlerësimit. Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim përgjegjësit të departamentit që mbulon lëndën përkatëse. |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Ka një procedurë hierarkike në rastet e ankimimeve. (Evidenca 5,6,7) Dokumenta për këtë nuk kishte. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **x** | |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit, lëndet e modulet, përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Përfshirja në program të MP në Fizioterapi të lëndëve/moduleve të lidhura me teknologjinë e informacionit, shkencave humane, sociale, të etikës e komunikimit, krijojnë mundësinë e aftësimit bazik edhe në këto fusha.<br>Ne gjuhë të huaj nuk ka në këtë nivel. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Nuk ka analizë të dokumentuar në përfundim të lëndës/modulit për kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e | Stafi akademik e ka bëre pjesë të punës tyre orientimin e studentit në ceshtjet e rëndesishme të lëndëve dhe për provimet përfundimtare.( Evidenca 5, 6, 7 ) |

| | |
|---|---|
| tyre dhe testin përfundimtar. | |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Na u dha informacion, që janë zhvilluar disa orë të hapura me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe persona të tjerë jashtë institucionit, të interesuar për ndjekien dhe pjesëmarrjen në këto aktivitete. Keto nuk janë të dokumentuara. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Ka vemendje te vecante në këtë pikë të mësimdhënies që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.<br>Kjo është e shprehur në strukturen dhe përmbajtjen e programit, në metodat dhe format e mësimdhenies që përdoren dhe janë detyrim e përgjegjesi që u ngarkon rregullorja, si e fakultetit dhe e programit.( Evidenca 6,7) |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik shpreh gatishmëri në pergjithësi për mbështetjen e studentëve për problemet e mbarvajtjes së studimeve. Keto dhe janë detyrim e përgjegjesi që u ngarkon rregullorja, si e fakultetit dhe e programit.( Evidenca 6,7) |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Puna shkencore vetë brenda Institucioni është e pamjaftueshme, megjithatë dëshira për mbështetje të studentëve nga personeli akademik në këtë drejtim u shpreh edhe gjatë vizitës në IAL Reald. |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Dëshira për mbështetje të studentëve nga personeli akademik në këtë drejtim u shpreh edhe gjate vizitës në IAL Reald.<br>Por konkretisht nuk kishte raste të dokumentuara. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Për rritjen e mobilitetit të studentëve pas marrëshjeve që po zhvillohen me Italinë (U.Fogias) sipas edhe eksperiences fituar me Bachelorin Fizioterapi janë parashikuar të tilla deri edhe në mbrojtje doktorature. Vetë lëndët dhe programi, orët dhe ECTS janë pasqyrim i dhënies mundësi studentëve për mobilitet. |

| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Si brenda dhe në institucionet bashkepunuese (spitali Vlorë) apo Klinika "Fizio Life" me te cilët kanë marrëdhënie IAL Reald, njësitë përgjegjëse garantojnë mjedise të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.<br>(Evidenca 33) |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | IAL Reald dhe Spitali Vlore apo Klinika "Fizio Life" si partnere garantojnë realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.<br>(Evidenca 33 dhe 25) |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Praktika mësimore vlerësohet me notë, dhe mbart kredite sipas përcaktimit në programin mësimor të miratuar, ajo është 240 orë apo 33.2% të orëve mësimore të programit.<br>Nuk na u paraqit ndonjë material specific apo shoqërues me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës per praktikat. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **x** | |

| **Standardi III.9**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Institucioni dhe Njësia kane procedurë të qartë të miratuar për provimin final dhe diplomimit të studentëve. Kjo procedurë është publike dhe gjendet në faqen elektronike të IAL. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloret përkatëse të IAL, njësive e programit. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Bëhet kujdes nga strukturat dhe personeli akademik duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. Çdo student, i cili harton temën për mbrojtjen e diplomës mbikëqyret gjatë të gjitha fazave të hartimit të temës nga një pedagog me gradë shkencore, për këtë vit me vendim te Nr 3 dt 14.3.2019 te Fakultetit Shkencave Mjeksore, janë percaktuar drejtuesit shkencorë per studentet. ( Evidenca 5, 6 dhe 7 ) |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Komisioni për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Numri i vogël i studentëve e mundëson këtë më së miri. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave. | Drejtuesit e temave të diplomës propozohen nga departamenti sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe miratohen nga Rektori (Kreu VIII neni 64 i Rregullores së IAL Reald.<br>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit për mbrojtjen e diplomave. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Institucioni nëpërmjet personelit akademik që ka lidhje të ngushta me Spitalin Vlore dhe Klinikën "Fizio Life" asiston studentët për kyerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e veta apo edhe jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi shkencor i studentit caktuar nga departamenti, duke bashkpunuar nga afër me personelin e Spitalit Vlorë dhe Klinikes "Fizio Life" e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës, duke garantuar cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. (Evidenca 10) |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Studenti vlerësohet me note në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Studenti në përfundim të mbarimit të studimeve, pajiset me listën e notave, suplementin e diplomës dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MASR.<br>(Evidenca 14.1 dhe 15.2 ) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti në përfundim të studimeve pajiset me dokumentacionin përkates zyrtar të përcaktuar nga IAL Reald. Evidenca 14.1 dhe 15.2 |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. | Bazuar në rregullat zyrtare të arkivimit origjinalet dorzohen aty dhe Institucioni, (pasqyruar edhe ne Kreun e V neni 52 të rregullores se IAL Reald) ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | x |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. | Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.<br>Kjo na dha mundësi të krahasojme të dhënat e viteve akademike 2018-19 me ato 2019-20 ku u pa ndryshimi i përbërjes së stafit dhe raportit PAE/PAK, ndryshimi i ngarkesës që përballohej nga PAE dhe angazhime të tjera të nevojshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.<br>(Evidenca Nr.19, Nr.20) dhe Nr.23 Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë ne departament, por janë të paqarta për programin dhe të përgjegjësve për organizimin e programit të studimit, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. |
| **Kriteri 2** Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Procedurat për rekrutimin e personelit akademik ishin në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.<br>Ka rregullore të zyrës së burimeve njerëzore miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik ku janë përcaktuar procedurat e rekrutimit. Punësimi në Kolegjin Universitar Reald bëhet në mbështetje të Kodit të Punës, Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore përkatëse dhe Statutit të kolegjit. |
| **Kriteri 3**Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | IAL Reald ka adoptuar një praktikë proceduriale në shërbim te rekrutimit të personelit cilësor akademik. Evidenca Nr.5 neni 30 dhe 31 dhe Nr.6 neni 12 Kriteret propozohen e miratohen në rrugë hierarkike dhe janë transparente. |
| **Kriteri 4**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi | Kjo mënyrë e përzgjedhur dhe aplikuar nga IAL Reald garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të |

| | |
|---|---|
| dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dhe kjo krijon mundësinë e rekrutimit jo vetëm në Vlorë por edhe më gjerë. Por lidhur me programin MP Fizioterapi ka akoma mangësi në rekrutimin me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

**Standardi IV.2**
**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Mjediset dhe mundësitë e krijuara në këtë IAL janë realisht bashkëkohore dhe gjithëperfshirëse jo vetëm për personelin akademik por edhe për atë ndihmës, administratën etj. Mbështetja duket nga laboratorët auditorët dhe teknologjia bashkëkohore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Shprehet dëshirë nga strukturat kryesore te Institucionit dhe ka edhe angazhime konkrete për mbështetje të personelit që mbulon programin MP në Fizioterapi. Evidenca 34. U jepet mundesia e pjesmarrjes apo të referojnë në aktivitete dhe botimi I materialeve në Buletinin e IAL, ku gjithë pedagogët kanë akses dhe gjejnë edhe material që I shërbejnë kualifikimit tyre. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Nuk ka të dokumentuara të tilla programe, por mbeshtetje për kualifikim personeli ka në nivelin, që i mundësohet Kolegjit Universitar Reald. Evidenca 34 |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore | IAL Reald dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | studimeve të ciklit të dytë e specifikisht për MP ne Fizioterapi Dukej angazhimi i personelit, ata ishin prezent gjithë kohën dhe përgjigjeshin me përgjegjësi për detyrat që u ishin ngarkuar. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | IAL siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. (Evidenca 33). Numri i vogël i studentëve rregjistruar në programin MP në Fizioterapi e garanton më së miri përmbushjen e këtij kriteri. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | IAL Reald ofron mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik.<br>Madje po krijoheshin edhe mjedise të tjera bazuar kjo në vizionin për një zgjerim në të ardhmen. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | IAL Reald ka gjithë infrastrukturën e nevojshme, si laboratorë salla, auditore apo mjediset e tjera, dhe sipas natyrës specifike të programit një kabinet të kompletuar fizioterapie, që përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Aty vazhdohej të punohej për krijimin e mjediseve të reja po aq bashkëkohore. |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të | Ka në këtë institucion laborator të teknologjisë së informacionit me 20 vende 65m2, të pajisur me programe profesionale sipas |

| | |
|---|---|
| teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron. | natyrës së programit/eve të studimit që ofron. Këtë e pam gjatë vizitës në Institucion. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Institucioni si vetëm edhe në bashkepunim me partnerët e përmendur me sipër garanton, me kapacitetet që zotëron që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **x** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka brenda ndërtesës qendrore të IAL Reald ishte lehtësisht e aksesushme, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka ishte e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore, por që së shumti i përkasin fushave dhe programeve të përafërta. Studentët materialet specifike të programit u merrnin nga personeli akademik. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për | Biblioteka online nuk ofrohet për fushën specifike dhe programin MP në Fizioterapi. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | | | | |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Pajisjet e nevojshme për bibliotekën (por jo programe kompjuterike) janë kryesisht të plotësuara dhe mundësojnë shfrytezimin nga gjithë studentët. | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Sipas drejtuesve te IAL Reald po punohet për përditesimin e fondit egzistues duke planifikuar zëra specifike në funksion edhe të programit Fizioterapi. | | | |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Oraret e shërbimit te bibliotekes janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.<br>Punonjës biblioteke nuk na u paraqit dhe u shoqëruam nga drejtues te IAL. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | x | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Institucioni disponon sistem të menaxhimi SMI që ka edhe Rregulloren Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Rolin kryesor e ka njësia e Sekretarisë mësimore, e cila sipas edhe rregullores së saj, Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik) administron këtë informacion nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit MP në Fizioterapi. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit | Dokumentacioni dhe informacioni i lidhur me punën e personelin akademik, ndihmës dhe administrativ, si dhe marrveshjet me partnerë trajtohet nga SMI në përputhje me ligjet e udhezimet për këtë veprimtari administrative. |

| | |
|---|---|
| akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | (Evidenca 37) |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nëpërmjet këtij sistemi bëhet e mundur në IAL Reald që si për personelin edhe për studentët të sigurohet akses në to dhe transparencë. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | IAL Reald është kujdesur për këtë pjesë standardi, ka integruar platformën SMI që të mundësojnë komunikim interaktiv të studentit me personelin. Ka edhe Rregullore të Sistemit të Menaxhimit Të Informacionit (S.M.I) Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik.<br>(Evidenca 37) |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Me sistemin e menaxhimit që disponon IAL Reald garanton (dhe kjo pasqyrohet ne Rregulloren e SMI Kreun I Dispozita të Përgjithshme Neni 1 Qëllimi ) monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Sistemi është në përdorim nga stafi akademik dhe administrativ si dhe nga studentët e Kolegjit Universitar "Reald". Sistemi është një sistem i integruar me arkitekturë modulare duke krijuar mundësine e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave te Kolegjit Universitar "Reald". |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit vetëm në gjuhë shqipe.<br>Sipas drejtuesve është duke u punuar për ta publikuar edhe në anglisht. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin | Ka të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; plani për mbështetje |

| | |
|---|---|
| për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | financiare për një cikël të plotë studimi; Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit janë paraqitur në një (Tabelë përmbledhëse); Evidenca 40 nga IAL Reald |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmba[j] financimin e burimeve njerëzore n[ë] shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të proce[sit] mësimor, shpenzimet për bibliotek[ën] dhe pasurimin e literaturës e akses[in] në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Plani i financimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Institucioni kryen auditim, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij mbi bazen e rregullave financiare sanksionuar nga aktet ligjore e nenligjore të Republikes Shqipërisë. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. (Evidenca 40) |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Institucioni ka politikën e tij financiare dhe kujdeset që të planifikojë e te ndërhyjë në cdo rast kur kjo kërkohet në të mirë të mbarvajtjes programit. (Evidenca 40) |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për | IAL Reald dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Vetë fakti i krijimit të mjediseve të reja, financimi i aparaturave të reja këtë vit, cka u pa gjatë |

| | |
|---|---|
| përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | vizitës në Institucion flet për qëndrueshmeri financiare të këtij Institucioni |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | x | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

**Standardi V.1**
**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Ka procedura të miratuar për studentët që nga marrja e statusit të studentit deri në diplomimin e tyre. Këto procedura janë të parashikuara në rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati akademik neni 69. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Rregullore e programit Cikli i Dytë i Studimeve "Master profesional" në "Fizioterapi" neni 40 -43). |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë | Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato janë të publikuara në faqen elektronike të IAL.<br>Si edhe në Rregullore të programit Cikli i Dytë i Studimeve "Master profesional" në "Fizioterapi" Neni 38. |

| | |
|---|---|
| lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | IAL harton kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë, (Evidenca 5, 6 dhe 7.2) dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga ligjet për arsimin e lartë i dërgon në MASR para fillimit të vitit akademik. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | IAL përgatit dhe shpërndan postera për publikun në lidhje me programet e studimit që ofron, nga ana tjeter bën promovim në gjimnaze si në Vlorë dhe Fier. (Evidenca 39) |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Nëpërmjet SMI dhe Sekretarisë mësimore Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Sipas Kreut VI neni 56 të Rregullores se IAL Reald Institucioni ka percaktuar mënyrën e pranimeve për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kërkesat dhe dokumentacionin e studentëve që duan të transferohen në Kolegjin Universitar "REALD", sekretaria u`a përcjell fakulteteve përkatëse. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, në se pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e | IAL informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e |

| | |
|---|---|
| procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | studimit. (Rregullore e Institucionit Neni 57 – 60). |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | IAL informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Kriteret e procedurat pasqyrohen edhe në rregulloret e institucionit.( Evidenca 5, 6 dhe 7.2) |
